



BASHKIA  
TIRANË

---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr.142, datë 30.10.2020

**PËR  
EMËRTIMIN E NJË RRUGE NË TERRITORIN E BASHKISË TIRANË**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nënpika 1.7, shkronja “b”, nenit 54, shkronja “ll” dhe nenit 55, pika 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; nenit 3, të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004, “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar, shkresës nr.prot. 139/1, datë 28.03.2019 të ministrit të brendshëm “Plani i masave mbi finalizimin e procesit të emërtimeve të bulevardeve, rrugëve, rrugicave, shesheve, parqeve në Republikën e Shqipërisë dhe paisjen me adresë të shtetasve shqiptarë”, vendimit nr. 80, datë 26.07.2017 të Këshillit Bashkiak “Për krijimin e Komisionit Këshillimor për rishikimin e emërtimeve të pjesëve të territorit publik (bulevard, rrugë, rrugicë, shesh, park) dhe shpërblimin e anëtarëve të tij”, i ndryshuar, shkresës informuese të Komisionit Këshillimor me nr. 33041 prot., datë 29.09.2020 drejtuar Kryetarit të Bashkisë, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

1. Emërtimin “Ruga e Shëngjergjit”, rrugës sipas fragmentit të hartës, bashkëlidhur këtij vendimi.
  2. Çdo vendim i mëparshëm që bie në kundërshtim me pikën 1, të këtij vendimi, shfuqizohet.
  3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**K R Y E T A R**